

Si të përdorni në mënyrë korrekte një maskë higjienike

Që nga maji i vitit 2020 në Zvicër janë rihapur dyqanet, tregjet, muzetë, bibliotekat dhe shkolla e arsimit të detyrueshëm (kopshti + shkolla fillore dhe sekondare). Në qershor të 2020-tës mundë të rihapen edhe shumica e vendeve tjera. Sidoqoftë, jeta më nuk është si më parë.

Ne të gjithë tani jetojmë në një normalitet të ri: Koronavirusi nuk duhet përsëri të përhapet gjërisht edhe më tutje. Prandaj të gjithë njerëzit në Zvicër duhet të vazhdojnë të respektojnë rregullat:

- Për momentin nuk lejohet që të qëndrojnë sëbashku më shumë se 5 persona.
- Të gjithë njerëzit duhet të mbajnë distancë nga njerëzit e tjerë. Më së miri më shumë se 2 metra. Kjo vlen gjithashtu edhe nëse vetëm dy persona qëndrojnë sëbashku.

Në disa situata është mirë, nëse ju bartni një maskë, e cila mbulon hundën dhe gojën:

- Ju nuk jeni në gjendje që të mbani një distancë prej 2 metrash nga njerëzit e tjerë. Për shembull në komunikacionin publik (autobus, tramvaj tren)
- Ju gjendeni në një vendë ku duhet të bartni një maskë higjienike. Për shembull te parukieri (flokteri)

Shënime-sqarime për maskat

- Një maskë nuk mbron nga ndonjë infektim me Koronavirus
- Por, një maskë mundë të parandaloj, që një person i infektuar të infektojë të tjerët. (Nga infektimi deri te shpërthimi i sëmundjes zgjat 5 deri në 14 ditë. Një person që ende duket dhe ndjehet i shëndetshëm, tashmë mundë të jetë i sëmurë.)
- Edhe njerëzit me mjekërr mundë të bartin maskë. Me rëndësi është, që hunda dhe goja të jenë të mbuluara.
- Poashtu edhe njerëzit me syze mundë të bartin një maskë. Në këtë rastë maska shtërngohet (puthitet) mbi kurrizin e hundës. Syzet vendosen mbi maskën.
- Fëmijët nuk janë të detyruar të bartin maskë.

Është me rëndësi, që Ju të përdorni maskën në mënyrë korrekte.

1. Lani duart plotësisht gjithmonë para se të vendosni dhe të hiqni maskën.




2. Tërhiqeni maskën anash kapeni te mbajtëset elastike ose te lidhëset dhe mbajeni përpara gojës dhe hundës. Pjesa e brendshme e maskës është zakonisht e bardhë, pjesa e jashtme është e ngjyrosur (p. sh. jeshile ose blu). Nëse është i disponueshëm duhet që përshtatësi i hundës, një hark i ngurtë dhe i lakueshëm, të jetë sipër.



3. Tërhiqni mbajtëset elastike pas veshëve ose lidhni mbajtëset prapa kokës. Maska duhet të jetë e ngjitur (puthitur) me fytyrën.




4. Tërhiqeni maskën sipër kockës së hundës dhe poshtë nën mjekërr.



5. Shtypeni klipin (përshtatësin fleksibël) sipër kockës së hundës (nëse është i disponueshëm).



6. Kështu maska përshtatet saktësisht
E rëndësishme për mbajtësit e syzeve: Së pari maskën pastaj syzet
Mjekra e vogël (nën buzën e poshtme) dhe mjekrra e plotë mundën
me zvogëluar efektivitetin e maskës.



7. Gjatë bartjes evitoni prekjen e mbulesës së gojës dhe hundës.



8. Nëse maska është njomur nga lagështia e ajrit gjatë frymëmarrjes, ajo duhet të zëvendësohet.



9. Pas përdorimit hiqeni maskën me kujdes. Kapeni atë vetëm pas të mbajtësve elastikë ose të lidhësve



10. Hidhni menjëherë maskën në koshin e plehrave. Maskat e përdorura nuk duhet të lihen rreth e rrotull.

